

2470
89/6

1/2/24, 10:37 AM

Gmail - Përgjigje nga Bashkia Tiranë shkresës me nr. prot. 1706/1, date 16.07.2024



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Përgjigje nga Bashkia Tiranë shkresës me nr. prot. 1706/1, date 16.07.2024

E Drejta Per Informim <edrejtaperinformim@tirana.al>
To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>
Cc: "info@idp.al" <info@idp.al>

Wed, Jul 31, 2024 at 11:23 AM

Përsëritje,

Referuar shkresës së ardhur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përkatësisht me nr.1706/1 prot., datë 16.07.2024 protokolluar ju bëjmë me dije se ka përgjigje nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) si më poshtë vijon:

"Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, ardhur pranë IMT, Bashkia Tiranë, ju bëjmë me dije se:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në zbatim të Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" (i ndryshuar), Ligjit Nr.8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" (i ndryshuar), Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar), V.K.M Nr.408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"(i ndryshuar), V.K.M 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit".

Sa më sipër, ju informojmë se ju kemi kthyer përgjigje me anë të shkresës me Nr. 6110/1 Prot, datë 04.07.2024, ku Inspektorët e IMT , Bashkia Tiranë nga kontrolli i ushtruar në terren kanë konstatuar kundërvajtjen" Janë kryer punime ndërtimore pa leje, hapje grope si dhe themel me konstrukcion beton arme" për të cilën është mbajtur procedura ligjore.

Ju bëjmë me dije se nga ana e subjektit është paraqitur dokumentacioni tekniko ligjor justifikues për punimet e konstatuara;

- Kërkesë për spostim linje
- Leje spostimi linje nga OST
- Leje punimesh nga OST
- Kthim përgjigje nga OST
- Relacioni Teknik
- Planimetria e spostimit

Sa më sipër, procedura ligjore e mbajtur nga IMT, Bashkia Tiranë është mbyllur.

Bashkëlidhur kopje e proces verbalit me nr. 5081 datë 04.10.2022.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Ju urojmë ditë të mbarë

KOORDINATORE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT I NJESISË 2/B

SERIA NR: **0005081**

PROCES VERBAL
NR. 5081 DATË 04/10/2022
PËR
KONSTATIMIN E KUNDËRVAJTJES

Bazuar në Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, nenin 5.12 si dhe digji 107/2014 për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit dhe VKM 1108 dt. 13.05.2015 i Regullorës së Zhvillimit të Territorit i ndryshuar

Sot, më datë 04/10/2022 inspektorët e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, ZIZnj (pozicioni) Y. Beqiri, E. Brokollari, pasi ushtruan një kontroll në subjektin juridik/fizik: SHOQËRIJA E N.L.K SHPK TIRANË L31608018A në adresën Rruga Gjon Kristi, Souk Kështjës, Tiranë në kantierin e ndërtimit (adresa/vendi/lloji i zonës) Rruga Gjon Kristi, Souk Kështjës, Tiranë

në prezencë edhe të përfaqësuesit/ëve të subjektit SHOQËRIJA E N.L.K SHPK TIRANË i cili, pranon të nënshkruaj -; nuk pranon të nënshkruaj -; nuk i njihet identiteti -

KONSTATUAN

1. Kundërvajtja Jonc Kucer punon ndërtimin pa leje, kopje grope si dhe themel dhe konstruksion B/A
2. Parashikimi ligjor Vazhdimin e procedurës lejoie
3. Vlerësimi i situatës Është parë dokumentacioni teknik i tipit pronë i M.T. Bashkia Tiranë brenda afatit ligjor

PER KËTO ARSYE

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët vendosin për njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave

Inspektorët	Subjekti i kontrolluar (personat që kanë asistuar në inspektim)
1. <u>Y. Beqiri</u>	1. <u>S. Vllashtari</u>
2. <u>E. Brokollari</u>	2. <u>K. Koci</u>
3. _____	3. _____